



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE**

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
SEKTORI PËR TË DHËNAT E HAPURA DHE KONSULTIMIN PUBLIK**

Nr. 2427/4 prot.

Tiranë më 11.11.2025

VENDIM

Nr. 38 datë 11/11//2025

PËR

PRANIMIN E PJESSHËM TË ANKESËS

Në mbështetje të nenit 21, pikat 1/b, 3 dhe 4 të ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”,

KONSTATOVA SE:

Qendra Rinore H.A.N.A përfaqësuar nga znj. Besmira Lekaj, Drejtuese Ekzekutive (në vijim “Ankuesi”) ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrotjtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) ankesën Nr. 2427 prot., datë 24.09.2025 ndaj Organit Publik/Bashkia Lezhë (në vijim “Organi Publik”) me objekt *“Kërkesë për të rishikuar, shfuqizuar ose përsëritur procesin aprovues të Planit të Arsimit Parauniversitar 2026-2028 në Bashkinë Lezhë”*.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit bashkëlidhur, Komisioneri vlerëson se ankesa është depozituar në përputhje me parashikimet e bëra në nenin 21, pika 1/b të ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” (në vijim “Ligji 146/2014”), për shkak se projektakti është miratuar dhe si i tillë Ankuesi legjitimohet në paraqitjen e saj në afat.

Gjithashtu, Ankuesi legjitimohet në ngritjen e objektit të kësaj ankese në përputhje me pikën 1/b të nenit 8 të Ligjit 146/2014, në të cilën citohet shprehimisht se:” *...palët e interesuara në procesin e njoftimit dhe konsultimit publik janë shtetasit e Republikës së Shqipërisë dhe grupet e interesit....*”.

Qendra Rinore H.A.N.A në zbatim të objektit të veprimtarisë së saj, konsiderohet grup interesi në lidhje me konsultimin e Planit të Arsimit Parauniversitar 2026-2028 në Bashkinë Lezhë dhe për rrjedhojë ka të drejtë të marrë pjesë në procesin e njoftimit dhe konsultimit publik.

Pas vlerësimit të ankesës së Qendrës Rinore H.A.N.A, në përputhje me pikën 3 të nenit 21 të Ligjit 146/2014 në të cilit citohet se “...me marrjen e një ankese, Komisioneri i kërkon ankuesit dhe organit publik, kundër të cilit është bërë ankesa, të paraqesin parashtrimet me shkrim brenda 10 ditëve”, Komisioneri me shkresën Nr. 2427/1 prot., datë 26.09.2025 ka kërkuar nga Organi Publik të paraqesë parashtrime me shkrim brenda këtij afati.

Në vijim, Organi Publik, me shkresën Nr. 16836/1 prot., datë 07.10.2025 “*Kthim përgjigje mbi ankimin ndaj Bashkisë Lezhë*”, ka sqaruar lidhur me ndjekjen e procesit të njoftimit dhe konsultimit publik të parashikuar në Ligjin 146/2014 duke cituar se:

“...plani është hartuar në kuadër të Marrëveshjes së Bashkëpunimit të lidhur gjatë muajit Maj 2025, ndërmjet Bashkisë Lezhë dhe Shoqatës Kombëtare të Bashkive të Shqipërisë. Në zbatim të pikës 2.2 të Marrëveshjes, Bashkia Lezhë i ka përcjellë Shoqatës Kombëtare të Bashkive të Shqipërisë të gjitha të dhënat dhe informacionet e nevojshme për hartimin e draftit.

Sa i përket konsultimit publik, theksojmë se njoftimi është publikuar më datë 06.08.2025 dhe afati përfundimtar për dorëzimin e rekomandimeve ka qenë 26.08.2025 (20 ditë nga data e publikimit të njoftimit) dhe rekomandimet e dërguara nga Qendra Rinore H.A.N.A me datë 26.08.2025 janë marrë në shqyrtim nga Drejtoria e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve në adresën e emailit ka kthyer përgjigje për rekomandimet rast pas rasti...

Referuar dokumentacionit për secilin nga konsultimet publike (projekt-vendimi, relacioni, draft-plani, procesverbali)gjenden të publikuara përkatësisht si më poshtë:...

4. Plani i Arsimit Parauniversitar 2026-2028 <https://lezha.gov.al/per-organizmin-e-degjeses-publike-ne-lidhje-me-miratimin-e-planit-te-arsimin-parauniversitar-2026-2028/>

Shënim: Bashkëngjitur gjeni kopjet e vendimeve të Këshillit Bashkiak për secilin nga dokumentat strategjike, konfirmimit e vendimeve nga Prefekti i Qarkut Lezhë si dhe kthim përgjigjen për Qendrën H.A.N.A në lidhje me rekomandimet e përcjella.

Referuar sa më sipër parashtrohet nga Organi Publik, Komisioneri konstaton se veprimet e ndjekura nuk janë në përputhje me parashikimet e Ligjit 146/2014.

Konsultimi publik është një proces i hapur, i strukturuar dhe i parashikuar ligjërisht, përmes të cilit Organi Publik, njofton publikun dhe palët e interesuara për projektaktet, dokumentet, strategjitë ose masat që kanë interes publik, si dhe krijon mundësinë që qytetarët, organizatat e shoqërisë civile, bizneset dhe grupet e interesit të japin komente, sugjerime dhe rekomandime, duke kontribuar në formimin e vendimmarrjes. Ky proces synon të garantojë transparencën e veprimeve administrative, informimin ligjor të të interesuarve mbi qëllimet, alternativat dhe ndryshimet kryesore të dokumenteve në shqyrtim, si dhe pjesëmarrjen aktive të publikut në proceset vendimmarrëse. Konsultimi publik realizohet përmes njoftimeve publike, afateve të përcaktuara për dorëzimin e komenteve, dhe mënyrave të përshtatshme të komunikimit, sipas rregullave të përcaktuara nga legjislacioni përkatës.

Në lidhje me shkronjën a) të ankesës ku kërkohet që Zyra e Komisionerit “*të konstatojë shkeljet procedurale dhe ligjore të Bashkisë Lezhë gjatë hartimit, konsultimit, dhe miratimit të Planit të Arsimit Parauniversitar 2026-2028...*”, Komisioneri vëren se në rastin konkret

njoftimi për organizimin e dëgjësës publike lidhur me miratimin e Planit të Arsimit Parauniversitar 2026-2028, është bërë në datën 06.08.2025, ndërsa dëgjesa publike në kuadër të procesit të konsultimit publik është zhvilluar më datë 20.08.2025, referuar kjo Njoftimit Nr. 13730/2 Prot., datë 06.08.2025, publikuar në faqen zyrtare të Bashkisë Lezhë, <https://lezha.gov.al/per-organizmin-e-degjeses-publike-ne-lidhje-me-miratimin-e-planit-te-arsimin-parauniversitar-2026-2028/>, konfirmuar gjithashtu me shkresën Nr. 16836/1 Prot., datë 07.10.2025 *“Kthim përgjigje mbi ankimin ndaj Bashkisë Lezhë”*.

Ky veprim bie ndesh me pikën 2, të nenit 17 të Ligjit 146/2014, në të cilin parashikohen afatet taksative të njoftimit për palët e interesuara të ftuara për të marrë pjesë në takimet publike, procedurën që ndiqet për ti vënë në dispozicion palëve të interesuara kopje të projektaktit që do të diskutohet, si dhe kohën e nevojshme për përgatitje.

Konkretisht në dispozitën e sipërcituar parashikohet se: *“Palëve të interesuara, të ftuara për të marrë pjesë në takimet publike, u jepet koha e nevojshme për përgatitje. Në çdo rast, ato informohen jo më pak se 20 ditë pune përpara takimit publik, duke u vënë në dispozicion kopje të projektaktit që do të diskutohet”*.

Referuar parashtimeve të Organit Publik dhe dispozitës së sipërcituar nuk provohet ndjekja dhe zbatimi i kërkesave dhe procedurave të Ligjit 146/2014, mbi respektimin e afatit të njoftimit për takimet publike lidhur me rastin objekt ankimi. Komisioneri thekson se, ndjekja e procesit të bashkërendimit dhe administrimit të përgjithshëm të punës për garantimin e së drejtës për njoftimin dhe konsultimin publik, bëhet nga koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik i cili në kuptim të nenit 10 të ligjit të sipërcituar është përgjegjës për këtë proces.

Ndërkohë, lidhur me pretendimin e Ankuesit në shkronjat b), c) dhe d), në të cilat konkretisht kërkohet që Zyra e Komisionerit: *“b) të urdhërojë publikimin e menjehershëm të procesverbaleve, listës së pjesëmarrësve dhe përmbledhjes së komenteve me arsyet e pranimit/refuzimit në Regjistrin Elektronik të Konsultimeve dhe faqen zyrtare të bashkisë”;* *“c) të rekomandojë përsëritjen e konsultimit publik në një proces transparent, gjithëpërfshirës dhe me respektim të afateve ligjore”;*

“d) të përcaktojë detyrimet e bashkisë për të adresuar rekomandimet substanciale për bursat, transparencën e kontributeve vullnetare dhe depolitizimin e arsimit, duke kërkuar koordinim me DRAP”, Komisioneri vlerëson se nuk mund të dalë jashtë kornizës ligjore duke shqyrtuar çështje, të cilat dalin jashtë kompetencës së tij referuar parashikimeve të Ligjit 146/2014, e si rrjedhojë këto kërtime duhet të rrëzohen.

Në përfundim, bazuar në sa më sipër parashtruar, konsultimit të ligjit në tërësi, si dhe dispozitave të sipërcituara në veçanti, Komisioneri konstaton se procesi i konsultimit të Planit të Arsimit Parauniversitar 2026 - 2028 nga Organi Publik nuk është bërë në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 146/2014 *“Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”*.

Në këto kushte, për shkronjën a) të ankesës në të cilën kërkohet që Zyra e Komisionerit *“të konstatojë shkeljet procedurale dhe ligjore të Bashkisë Lezhë gjatë hartimit, konsultimit, dhe*

miratimit të Planit të Arsimit Parauniversitar 2026-2028...”, Komisioneri vlerëson se ankesa është e bazuar në ligj dhe në prova dhe si e tillë ajo duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në pikën 4 të nenit 21 të ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të Ligjit nr 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”

VENDOSA:

1. Pranimin pjesërisht të ankesës Nr. 2427 prot., datë 24.09.2025, të Qendrës Rinore H.A.N.A ndaj Organit Publik/Bashkia Lezhë, me objekt *“Kërkesë për të rishikuar, shfuqizuar ose përsëritur procesin aprovues të Planit të Arsimit Parauniversitar 2026-2028 në Bashkinë Lezhë”,* për shkronjën a), në të cilën kërkohet që Zyra e Komisionerit *“të konstatojë shkeljet procedurale dhe ligjore të Bashkisë Lezhë gjatë hartimit, konsultimit, dhe miratimit të Planit të Arsimit Parauniversitar 2026-2028....”.*
2. T’i propozoj Organit Publik/Bashkisë Lezhë, marrjen e masave administrative ndaj personit/personave përgjegjës (në kuptim të nenit 10 të Ligjit nr. 146/2014 për Njoftimin dhe Konsultimin Publik), sipas legjislacionit për shërbimin civil në fuqi.
3. Rrëzimin e ankesës për pretendimet e ngritura në shkronjat b), c) dhe d) të saj, në të cilat kërkohet që Zyra e Komisionerit *“b) të urdhërojë publikimin e menjehershëm të procesverbaleve, listës së pjesëmarrësve dhe përmbledhjes së komenteve me arsyet e pranim/ refuzimit në Regjistrin Elektronik të Konsultimeve dhe faqen zyrtare të bashkisë”;*
“c) të rekomandojë përsëritjen e konsultimit publik në një proces transparent, gjithëpërfshirës dhe me respektim të afateve ligjore”;
“d) të përcaktojë detyrimet e bashkisë për të adresuar rekomaandimet substanciale për bursat, transparencën e kontributeve vullnetare dhe depolitizimin e arsimit, duke kërkuar koordinim me DRAP”.
4. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.
5. Ky vendim u shpall sot më datë 11/11/2025.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi